



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:233135  
Datë: 09.08.2024  
Numri i dokumentit: 06035933

P.nr.241/21

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË**, Divizioni penal, me gjyqtarin Lulzim Paçarizi, si dhe me sekretaren juridike Behije Karaçica, në çështjen penale ndaj të akuzuarit personit juridik subjekti „E.B.” Sh.p.k, për shkak të veprës penale shmangia nga Tatimi nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 40 dhe 81 të KPRK-së(Kodi Penal nr. 04/L-082), dhe të akuzuarit personit përgjegjës H.K., për shkak të veprës penale shmangia nga Tatimi nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së (Kodi Penal nr. 04/L-082), ndërsa sipas aktakuzës PP.nr.1404/21 të dt.06.12.2021, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar të dt.19.07.2024, ku prezent ishin Prokurori i shtetit Venera Shala, përfaqësuesi i personit Juridik „E.B.”, N.K.me autorizim, i akuzuari H.K.me mbrojtësin e tij av. H.K.nga Malisheva me autorizim, gjykata me dt.22.07.2024, merrë ndërsa me dt. 09.08.2024 e përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

### TË AKUZUARIT:

**1.Personi Juridik „E.B.”**, Shpk, me numër biznesi:... me seli në B.komuna Malishevë, me përfaqësues të autorizuar N.K..

**2. H.K.**, personi përgjegjës i personit juridik, nga i ati G. dhe e ëma H. e lindjes K., i lindur më datën ..., në fshatin B.komuna Malishevë, me nr.personal:..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, i ati i 4 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, person përgjegjës, i gjendjes së mesme ekonomike.

## Ë S H T Ë F A J T O R Ë

### I akuzuari /personi juridik „E.B.” SH.P.K

1. Në periudhën kohore nga muaji Janar i vitit 2018 e në vazhdimësi deri në muajin Janar të vitit 2020, në fsh. B.Komuna Malishevë, e pandehura si person juridik „E.B.” SH.P.K, me nr. Identifikues (NRB) ... dhe nr. fiskal ..., përmes personit përgjegjës/pronarit H.K., duke vepruar në kuadër të veprimtarisë së tij afariste, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete, e me qëllim që ti shmanget pjesërisht apo tërësisht pagesës së tatimit, tarifave apo kontributeve tjera të përcaktuara me ligj,

nuk i përfshinë informatat lidhur me të ardhurat e saj, gjendjen ekonomike dhe faktet tjera relevante për vlerësimin e detyrimeve, në atë mënyrë që nga fillimi i muajit Janar të vitit 2018 e deri në muajin Janar të vitit 2020, ka fshehur faktet lidhur me të ardhurat dhe veprimtarinë ekonomike të personit juridik "E.B." me seli në fsh. B.Komuna Malishevë, ashtu që nuk i ka deklaruar në A. T. të Kosovës të hyrat që ka realizuar në kuadër të aktivitetit afarist, dhe po ashtu nuk i ka paguar detyrimet Tatimore të përcaktuara me ligj, me ç 'rast Administratës Tatimore të Kosovës, respektivisht Buxhetit të konsoliduar të Republikës së Kosovës, i ka shkaktuar dëm material duke ju shmangur pagesës së tatimit në shumën prej 10,135.40 Euro.

- Me këto veprime, ka kryer veprën penale Shmangia nga Tatimi nga neni 313 par. 1 lidhur me nenin 40 dhe 81 të KPRK-së (Kodi Penal nr. 04/L-082),

### **I akuzuari H.K.**

**II.**Në periudhën kohore nga muaji Janar i vitit 2018 e në vazhdimësi deri në muajin Janar të vitit 2020, në fsh. B.Komuna Malishevë, i pandehuri H.K., si pronar dhe person përgjegjës i personit juridik "E.B." sh.p.k, gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, me qëllim që ti shmanget pjesërisht apo tërësisht pagesës së tatimit, tarifave apo kontributeve tjera të përcaktuara me ligj, nuk i përfshinë informatat lidhur me të ardhurat e saj, gjendjen ekonomike dhe faktet tjera relevante për vlerësimin e detyrimeve, në atë mënyrë që nga fillimi i muajit Janar të vitit 2018 e deri në muajin Janar të vitit 2020, ka fshehur faktet lidhur me të ardhurat dhe veprimtarinë ekonomike të personit juridik "E.B." me seli në fsh. B.Komuna Malishevë, ashtu që nuk i ka deklaruar në A.T.K.të hyrat që ka realizuar në kuadër të aktivitetit afarist, dhe po ashtu nuk i ka paguar detyrimet Tatimore të përcaktuara me ligj, me ç 'rast Administratës Tatimore të Kosovës, respektivisht Buxhetit të konsoliduar të Republikës së Kosovës, i ka shkaktuar dëm material duke ju shmangur pagesës së tatimit në shumën prej 10,135.40 Euro.

- Me këto veprime, ka kryer veprën penale Shmangia nga Tatimi nga neni 313 par. 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së (Kodi Penal nr. 04/L-082), .

Andaj gjykata konform nenit 4, 7, 17, 38, 39, 40, 43, 44, 69, 71 par.1 nënpar.1.3 dhe nenit 313 par.1 lidhur me nenin 40 dhe 81 të KPRK-së dhe nenit 364 KPP-së të njëjtit i:

### **G J Y K O N**

1. Të akuzuarin personin juridik „E.B.” sh.p.k, me seli në fshatin B.komuna Malishevë, me përfaqësues të autorizuar N.K., me dënim me gjobë në lartësi prej **njëmijë (1000) euro**, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në xhirollogarinë e kësaj gjykate në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

2. Të akuzuarin H.K., personi përgjegjës i "E.B." sh.p.k, me dënim me gjobë në lartësi prej **700 (shtatëqind) euro**, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj

në xhirollogarinë e kësaj gjykate në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- Si dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajve burg**.

Në kuptim të nenit 44 të KPRK-së, me kërkesën dhe pëlqimin e të akuzuarit H.K.dhe mbrojtësit të tij av. H.K., gjykata dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajve**, ia zëvendëson me dënim me gjobë në shumën prej **1300 (njëmijëetreqind) euro**, të cilën gjobë duhet ta paguaj duke filluar 30 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Konform nenit 76 par.1 dhe 2 pika 2.4 të KPRK- gjykata e gjykon me **DËNIM UNIK:**

**ME GJOBË në shumën prej 2000 (dymijë) euro**, dënimin e shqiptuar me gjobë do ta paguaj në afat prej 30 ditësh, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë. Po që se dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej njëqindtridhjetëpesë (100) ditësh, duke llogaritur çdo ditë burgu me nga 20 €.

E dëmtuara Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me kërkesën pasurore juridike, udhëzohet në kontestin civil.

Obligohet i akuzuari personi juridik "E.B." sh.p.k dhe i akuzuari H.K.në emër të paushallit gjyqësor që të paguaj shumën prej 20 € (njëzet euro) secili, dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 € ( njëzet euro) secili, ndërsa shpenzime të procedurës nuk ka pasur, të gjitha këto pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi do behet me detyrim.

## A r s y e t i m

### 1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1404/21 të dt.06.12.2021, i ka akuzuar personit juridik subjekti „E.B.” Sh.p.k, për shkak të veprës penale shmangia nga Tatimi nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 37 dhe 77 të KPRK-së(Kodi Penal nr. 04/L-082), dhe të akuzuarit H.K., për shkak të veprës penale shmangia nga Tatimi nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së (Kodi Penal nr. 04/L-082), duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt.19.07.2024, ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës, prokurori i shtetit Venera Shala, përfaqësuesi i personit juridik „E.B.” shpk, N.K.me autorizim, i akuzuari H.K.me mbrojtësin e tij av. H.K.me autorizim, andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

Prokurori i shtetit me rastin e leximit të aktakuzës ka bërë përmirësim të kualifikimi i veprës penale , kryesisht të përgjegjësia e personit juridik ku në vend të nenit 37 duhet të jete neni 40, ndërsa në vend të nenit 77, duhet të jetë neni 81 , gabimi i njëjti ka rrjedhë edhe te dispozitivi i dytë , ku në vend lidhur me nenin 77 duhet të jete lidhur me nenin 81 të KPRK-së, (Kodi Penal 04/L-082)

I akuzuari personi juridik „E.B.” sh.p.k, përfaqësuesi i autorizuar N.K., në shqyrtimin fillestar është deklaruar i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohet, duke shtuar se me vjen keq për rastin i cili ka ndodhur, për të cilën jam penduar.

I akuzuari H.K.personi përgjegjës i personit juridik “E.B.” sh.p.k, pas konsultimit me mbrojtësin e tij av. H.K., është deklaruar i fajshëm për veprën penale për të cilat ngarkohet, duke shtuar se me vjen keq për rastin i cili ka ndodhur, për të cilën jam penduar.

Mbrojtësi i të akuzuarit H.K., av. H.K.ka deklaruar: Meqenëse i mbrojturi im e ka pranuar fajësinë sa i përket veprës penale si në dispozitiv të aktakuzës, në mënyrë vullnetare pas konsultimit paraprake, duke ia shpjeguar efektet dhe benefitet e pranimit të fajësisë, andaj kërkoj nga gjykata që të provohet pranimi i fajësisë, po ashtu i mbrojturi im veprën penale si në dispozitiv të aktakuzës , sa i përket shumës në aktakuzë të njëjtën është duke e paguar dhe përveç borxheve tjera të cilat i përmban marrëveshja e dt. 14.06.2024 e lidhur ne mes të akuzuarit H.K.dhe Administratës Tatimore, dhe përveç këtyre borxheve në këtë marrëveshje është e inkorporuar apo përfshirë edhe shuma prej 10,135.40 euro, dhe nga një kopje të kësaj marrëveshje ia dorëzojmë si gjykatës ashtu edhe prokurorisë. I propozoj gjykatës; që më rastin e shqiptimit të dënimit ti ketë për bazë rrethanat lehtësuese siç janë pranimi i fajësisë, po ashtu edhe për faktin se asnjëherë tjetër nuk ka kryer ndonjë vepër penale dhe as që është duke u zhvilluar ndonjë procedurë tjetër dhe meqenëse e ka pranuar edhe fajësinë ti shqiptoj një dënim sa më të butë. Meqenëse për këtë vepër penale Kodi Penal ka paraparë dy dënime, me dënim komolativ i propozoj gjykatës që në rast se shqiptohet dënimi me burg i propozojmë dhe japim pëlqimin që i njëjti të zëvendësohet me dënim me gjobë.

Prokurori i shtetit Venera Shala, në shqyrtimin fillestar ka deklaruar : Se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë na ana e të akuzuarit në cilësinë të personit juridik „E.B.” dhe të akuzuarit H.K.si person përgjegjës, për faktin se i njëjti u sqarua mjaftueshëm nga ana e gjykatës dhe pas konsultimeve te tij me mbrojtësin av. H.K.n, lidhur me benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, gjithashtu ky pranim fajësie gjenë mbështetje të plotë në fakte të çështjes të prezantuar në këtë aktakuzë si dhe aktakuza nuk përmban gabime faktike apo shkelje ligjore. Andaj kërkoj nga gjykata që këtë pranim fajësie ta pranoj si shprehje të vullnetit të lirë në cilësi të personit juridik N.K.dhe personit përgjegjës H.K.. Sa i përket caktimit dhe llojit të lartësisë së dënimit kërkoj nga gjykata të merr parasysh , pranimin e fajësisë nga të akuzuarit, premtimin se ne te ardhmen do te jenë të kujdesshëm , për herë të parë kanë ra ndesh me ligjin, e gjithashtu nga personi përgjegjës u prezantua sot edhe një marrëveshje nga ATK e dt. 14.06.2024, lidhur me pagesën e dëmit bashkë me borxhet tjera me këste, si rrethanë

lehtësuese, ndërsa sa i përket rrethanave rënduese kërkoj nga gjykata që të merr parasysh për të dy të akuzuarit përgjegjësinë penale të personit juridik, shkallen e përgjegjësisë penale të personit përgjegjës, si dhe rrezikshmërinë e kësaj vepre penale për dëmtimin e buxhetit të Republikës së Kosovës, respektivisht ATK-së.

## 2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së. Gjatë pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

## 3. Gjendja faktike e vërtetuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

- se i akuzuari personi juridik „E.B.” shpk, me përfaqësues të autorizuar N.K.me dashje ka kryer veprën penale shmangia nga Tatimi nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 40 dhe 81 të KPRK-së(Kodi Penal nr. 04/L-082), dhe i akuzuari H.K.personi përgjegjës i “E.B.” sh.p.k, për shkak të veprës penale shmangia nga Tatimi nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së (Kodi Penal nr. 04/L-082) në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivet e këtij aktgjykimi.

Gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë:

- Libri i blerjeve datë.01.01.2018-31.01.2020;
- Libri i shitjeve datë.01.01.2018-31.01.2020;
- Transaksionet bankare për përudhen 01.01.2018-31.01.2020
- Stoqet, rezervat për periudhën 2018, 2019 deri me dt.02.03.20202;
- Raporti i kontrollit dt.17.08.2020;
- Vendimi i divizionit të ankesave (A.) nr.302/2020 dt.10.11.2020;
- Gjendja nga S. dt.31.08.2021;
- Deklarata e përfaqësuesit të palës së dëmtuar R. A. e dhënë në Prokurori me dt.22.10.2021;
- Deklaratat e të pandehurit H.K.e dhënë ne Prokurori me dt.26.11.2021;
- Si dhe shkresat tjera të lendes.

## 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 313 par.1 të KPRK-së është parashikuar: „Kushdo që me qëllim që ai apo personi tjetër të fsheh apo t'i shmanget, pjesërisht apo tërësisht, pagesës së tatimit, tarifave apo kontributeve të tjera që kërkohen me ligj, jep të dhëna të pavërteta aponuk i përfshin të dhënat lidhur me të ardhurat e tij, pasurinë, gjendjen ekonomike apo fakte të tjerarelevante për vlerësimin e detyrimeve të tilla, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet. Neni 40 parasheh, „ Personi juridik është përgjegjës për veprën penale të personit përgjegjës, i cili ka kryer veprën penale duke vepruar në emër të personit juridik brenda autorizimeve të tij, me qëllim të përfitimit të dobisë apo ka shkaktuar dëm për atë person juridik. Përgjegjësia e personit juridik ekziston edhe nëse veprimet e personit juridik kanë qenë në kundërshtim me politikën e afarizmit ose me urdhrat e personit juridik”.

#### 5. Vendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarit i ka shpallur fajtor për veprat penale për të cilat ngarkohen, nga se në veprimet e tyre të përshkruara si në dispozitivat e aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprës penale shmangia nga Tatimi nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 40 dhe 81 të KPRK-së(Kodi Penal nr. 04/L-082), për këtë ka vendosur që të akuzuarit t'i shpallë fajtor dhe t'i gjykoj në bazë të ligjit, e me parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

#### 6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-së ashtu që gjykata me rastin e caktimit të dënimit pati parasysh rrethanat lehtësuese si:

I. Për të akuzuarin - personi juridik “ E.B.” sh.p.k me seli në fshatin B.komuna Malishevë, me përfaqësues të autorizuar N.K., gjykata mori parasysh faktin se më parë ka qenë i pa dënuar për kryerjen e ndonjë vepre penale, ka pasur qëndrimi tejet korrekt si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale. Si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar për veprën penale për të cilën ngarkohet, ndërsa si rrethanë renduese gjykata gjeti dëmtimin e buxhetit të Republikës së Kosovës, gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin konkret ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 71 par.1 nënpar.1.3 1.3 të KPRK-së dhe në rastin konkret ka aplikuar dispozitivin e nenit 9 par.1 të Ligjit Nr.04/L-030 për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale kur ka shqiptuar dënimin me gjobë nën kufijtë e përcaktuar me ligj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për veprën penale nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 40 dhe 81 të KPRK-së(Kodi Penal nr. 04/L-082).

II. Për të akuzuarin - personi përgjegjës i personit juridik “E.B.” sh.p.k H.K.nga fshati B.komuna Malishevë, gjykata mori parasysh faktin se është familjar, baba i 4

fëmijëve, i pa dënuar më parë për kryerjen e ndonjë vepre penale, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale, si dhe pranimin e fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar, ndërsa si rrethanë renduese gjeti mos kryerjen e obligimeve ndaj A.-së.

7. Vendimi mbi udhëzimin në kontestin civil

Vendimin mbi udhëzimin në kontestin civil është marr konform nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPK-së.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 të KPPK-së, ndërsa vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 parg.3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISEHVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**  
**P.nr.241/21, me dt.22.07.2024.**

Sekretarja juridike  
**Behije Karaçica**

Gjyqtari i vetëm gjykues  
**Lulzim Paçarizi**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.